



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 225/1 prot.

Tiranë, më 10 . 02 . 2026

V E N D I M

Nr. 26 , datë 10 . 02 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 30 Regj., datë 27.01.2026, paraqitur nga shtetasja T. Ç, kundër shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Fier, me pretendimin për diskriminim, për shkak të gjendjes shoqërore, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon Komisionerin, se: “Unë T. Ç, jam e punësuar si sanitare pranë shkollës 9-vjeçare “Naim Farshëri”, Fier. Prej vitesh vuaj nga një sëmundje kronike, e dokumentuar me fletë - dalje spitalore, që nga viti 1998 dhe me epikrizë mjekësore pas ndërhyrjes kirurgjikale në vitin 2012. Për disa vite kam qenë përfituese e asistencës së paaftësisë në punë (KMCAP), e cila më është hequr së fundmi.

Për shkak të gjendjes sime shëndetësore dhe natyrës së rëndë të punës që kryej, kam paraqitur vazhdimisht kërkesa pranë Bashkisë Fier për ndërrim pozicioni pune ose për sistemim në një ambient më të përshtatshëm, por këto kërkesa nuk janë marrë asnjëherë parasysh.

Nga data 12 – 15 janar 2026, kam qenë me raport mjekësor 3 ditor, çka justifikon mungesën time në punë gjatë kësaj periudhe. Pavarësisht kësaj, me datë 15.01.2026, ditën e kthimit tim në punë, jam

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

përballur me presion psikoogjik, britma dhe kërcënime lidhur me vendin e punës nga A. Ç dhe S. L, në bashkëpunim me njëra – tjetrën.

Më datë 23.01.2026, ora 14:45, jam thirrur në Qendrën Ekonomike, pranë Bashkisë Fier, për të firmosur një procesverbal me konstatime të pavërteta për moskryerje detyrash në datën 15.01.2026, në orën 09:30, pa më dhënë kohë reale për kryerjen e tyre.

Drejtoresha e Qendrës Ekonomike/Bashkia Fier, S. L, e lexoi vetë procesverbalin dhe tentoi të më detyronte ta firmosja, pa më dhënë të drejtën ta lexoja vetë dokumentin ose të merrja kopje të tij. Këtë procedurë nuk e kam pranuar dhe nuk e kam firmosur procesverbalin. Puna dhe sjellja ime kontrollohen nga nëndrejtoresha, e cila nuk është pyetur asnjëherë.

Të gjitha këto veprime përbëjnë trajtim të padrejtë dhe diskriminues ndaj meje, pasi nuk është marrë parasysh gjendja ime shëndetësore dhe nuk më janë ofruar kushte të arsyeshme pune. Përkundrazi ndaj meje është ushtruar presion i vazhdueshëm për largim nga puna.”

Subjekti ankues, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatohet diskriminimi nga ana e shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Fier, për shkak të gjendjes shoqërore, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar, si dhe të merren masat përkatëse për rregullimin e situatës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 7/1 i LMD-së³, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi

³ Shkurtesë për Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Në Kreun II, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në lidhje me të drejtën e tij për punësim.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim, subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit të datës 06.02.2026, të dërguar në adresën e KMD-së, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, duke u shprehur ndër të tjera, se: *“Ju falenderojmë për komunikimin dhe bashkëpunimin tuaj lidhur me ankesën nr. 30 Regj., datë 27.01.2026. Pas një rivlerësimi të situatës kemi vendosur të heqim dorë nga vijimi i ankesës nr. 30 Regj., për sa i përket institucionit arsimor (shkollës. ...Në këtë rast, kërkojmë me respekt që të gjitha provat, dokumentet dhe përgjigjet e dhëna në kuadër të ankesës nr. 30, që lidhen me Bashkinë Fier, t’i kalohen për administrim ankesës nr. 32 Regj., datë 29.01.2026, e cila do të vijojë të trajtohet vetëm ndaj Bashkisë Fier.”*

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

⁴ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Në nenin 94⁵/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, T. Ç, e cila, me anë të e-mailit të datës 06.02.2026, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 06.02.2026, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 30 regj., datë 27.01.2026, të paraqitur nga ankuesja T. Ç, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁶.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 30 Regj., datë 27.01.2026, të T. Ç, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ *“Tërheqja e ankesës”*.

⁶ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 230, datë 07.11.2023, Vendimin nr. 104, datë 22.04.2024, Vendimin nr. 124, datë 30.04.2024, Vendimin nr. 146, datë 23.06.2025, të KMD-së.